



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA Durrës
KËSHILLI BASHKIAK

VENDIM

Nr. 61, datë 17.07.2026

PËR MIRATIMIN E LISTËS SË PËRFITUESVE NGA PROGRAMI I PROCESIT TË RINDËRTIMIT TË PALLATIT KASTRATI NR.14, RRUGA “RAMADAN VELIU”

Në mbështetje të Ligjit nr. 139/2015, “Për vetëqeverisjen vendore”, të ndryshuar; Aktit Normativ nr. 9, datë 16.12.2019, “Për përballimin e pasojave të fatkeqësisë natyrore”, miratuar me Ligjin nr. 97/2019, Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 750, datë 27.11.2019, “Për shpalljen e gjendjes së fatkeqësisë natyrore në qarqet Durrës, Tiranë dhe Lezhë”, të ndryshuar, Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 904, datë 24.12.2019, “Për përcaktimin e rregullave, të kategorive prioritare, masës së përfitimit, autoriteteve përgjegjëse dhe procedurave për vlerësimin dhe përzgjedhjen e përfituesve nga disa programe të procesit të rindërtimit”, të ndryshuar, Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 5, datë 08.01.2020, “Për përcaktimin e procedurave për përfitimin nga programi i granteve të rindërtimit”, të ndryshuar, si dhe në zbatim të Urdhrit të Kryetarit të Bashkisë nr. 164, datë 26.05.2020, “Për ngritjen e Komisionit të Posaçëm për vlerësimin dhe përzgjedhjen e përfituesve nga programet e procesit të rindërtimit”, të ndryshuar, dhe Urdhrit nr.234, datë 18.08.2025, “Për riformatimin e Komisionit të Posaçëm për vlerësimin dhe përzgjedhjen e përfituesve nga programet e procesit të rindërtimit”, procedurës së ndjekur nga Zyra e Posaçme e Rindërtimit, Rikonstruksionit dhe Rimëkëmbjes Ekonomike, si dhe sipas relacionit të përgatitur nga Komisioni i Posaçëm i Rindërtimit, me propozim të Kryetares së Bashkisë



KËSHILLI BASHKIAK
VENDOSI:

1. Miratimin e listës përfituesve nga programi i procesit të rindërtimit për pallatin “Kastrati” nr.14, rruga “Ramadan Veliu”, në njësinë administrative nr.5”, Durrës, i dëmtuar nga

fatkeqësia natyrore e tërmetit të datës 26 nëntor 2019, sipas listës së mëposhtme, të cilët përfitojnë nga rindërtimi i objektit në të njëjtin truall, si më poshtë vijon:

Nr.	PRONARI	GJENDJE FAMILJARE SIPAS ÇERTIFIKATËS	STRUKTURA E APARTAMENTIT QË DO PËRFITOHET	Programi
1	Zaim Hamzaj	4	2+1	Rindërtim në të njëjtin truall
2	Nexhmije Xhelili	6	3+1	Rindërtim në të njëjtin truall
3	Shkëlzen Hadroj	4	2+1	Rindërtim në të njëjtin truall

2. Për zbatimin e këtij vendimi ngarkohen Zyra e Posaçme e Rindërtimit, Rikonstruksionit dhe Rimëkëmbjes Ekonomike, si dhe Komisioni i Posaçëm.

Ky vendim hyn në fuqi sipas përcaktimeve të nenit 55, pika 6, të Ligjit Nr.139/2015, “Për vetëqeverisjen vendore”, i ndryshuar.

KRYETARE

Denisa Luarasi



U shpall sot me datë 20.07.2026




REPUBLIKA E SHQIPËRISË
PREFEKTI I QARKUT Durrës

Nr. 566/9 prot.

Durrës, më 27 . 07 .2026

Lënda: Verifikim i ligjshmërisë së aktit

**KËSHILLIT BASHKIAK
DURRËS
KRYETARIT TË BASHKISË
DURRËS**



Verifikova ligjshmërinë e Vendimit të Këshillit Bashkiak Durrës nr. 61 datë 17.07.2026 “ Për miratimin e listës së përfituesvë nga programi i procesit të rindërtimit të pallatit “Kastrati” nr.14, rruga “Ramadan Veliu”. ”.

Ky vendim në bazë të Ligjit nr 44/2015 “Kodi i Procedurave Administrative” neni 3 pika 2 nuk është akt me karakter normativ. Vendimi është akt administrativ individual bazuar në nenin 3 pika 1/a të Ligjit nr 44/2015 “Kodi i Procedurave Administrative”, pasi i drejtohet subjekteve të përcaktuar individualisht duke krijuar një marrëdhënie juridike konkrete si dhe është i shteruar në zbatimin e tij.

Në bazë të Ligjit Nr.107/2016 “Për Prefektin e Qarkut”i ndryshuar (neni 8/a) “Prefekti i qarkut verifikon ligjshmërinë e akteve me karakter normativ të organeve të vetëqeverisjes vendore”.

Për sa më sipër verifikimi i këtij vendimi duke qenë një akt administrativ me karkater individual **nuk është në kompetencën e Prefektit të Qarkut.**

**PREFEKTI
ADRIAN GURRA**

